

VENDIM
Nr. 515, datë 30.8.2023

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR BASHKËPUNIMIN NË
LEHTËSIMIN E PROCEDURAVE NË PIKAT E INSPEKTIMIT
KUFITAR, PËR PRODUKTET ME ORIGJINË JOSHTAZORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në lehtësimin e procedurave në pikat e inspektimit kufitar, për produktet me origjinë joshtazore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, MBI BASHKËPUNIMIN NË LEHTËSIMIN
E PROCEDURAVE NË PIKAT E INSPEKTIMIT KUFITAR PËR PRODUKTET ME
ORIGJINË JOSHTAZORE**

Me qëllim promovimin e tregtisë, heqjen e barrierave dhe lehtësimin e procedurave të kontrollit, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Kosovës, në vijim të referuara si “Palët”;

duke pasur parasysh marrëdhëniet ndërqeveritare të deri tanishme, të zhvilluara në mënyrë të favorshme;

me synim forcimin dhe shtrirjen e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, si dhe zhvillimin e bashkëpunimit në fushën e bujqësisë;

kanë rënë dakord, si më poshtë:

Neni 1

Autoritetet kompetente të Palëve për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, janë:

- Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

- Për qeverinë e Republikës së Kosovës: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Neni 2

Palët bien dakord se kontrolli në import, tranzit dhe eksport të produkteve ushqimore me origjinë joshtazore, mund të kryhet në Pikën e Inspektimit Kufitar ose në doganën më të afërt të vendit të destinacionit, sipas kërkesës së subjektit.

Kontrollet kryhen në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionet e sigurisë ushqimore.

Neni 3

Palët bien dakord që autoritetet përgjegjëse për sigurinë ushqimore të secilës palë do të lejojnë importin dhe eksportin, shoqëruar me certifikata të njohura ose raport-analiza apo dokument tjetër të përshtatshëm, të lëshuar sipas legjislacionit të secilës palë, që garanton sigurinë ushqimore.

Neni 4

Palët bien dakord që autoritetet kompetente të secilës palë do të njoftojnë njëra-tjetrën për planet e kontrollit me bazë risku dhe aktet rregullatore që miratohen në fushën e sigurisë ushqimore.

Neni 5

Çdo Palë kryen kontrole të ngarkesave të ushqimeve me origjinë joshtazore, gjatë importit dhe eksportit, bazuar mbi analiza risku, sipas legjislacionit të palëve.

Neni 6

Me qëllim zhvillimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë ushqimore, autoritetet kompetente të Palëve do të shkëmbejnë publikime profesionale dhe organizojnë trajnime të përbashkëta.

Neni 7

Mosmarrëveshjet që lindin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje zgjidhen ndërmjet përfaqësuesve të autoriteteve kompetente të Palëve.

Neni 8

Marrëveshja nuk zbatohet për të drejtat dhe detyrimet e shteteve Palë që lindin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare në të cilat janë palë kontraktuese.

Neni 9

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin Palët njoftojnë njëra-tjetrën, përmes kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore, të kërkuara për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje është për 5 vjet, që nga momenti i nënshkrimit të saj. Do të zgjatet automatikisht për një periudhë tjetër prej 5 vitesh, përveç kur njëra prej Palëve kërkon ndërprerjen e saj me shkrim nëpërmjet rrugëve diplomatike, të paktën 3 muaj para përfundimit të periudhës përkatëse të vlefshmërisë.

3. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me miratimin reciprok me shkrim të Palëve, në çdo kohë. Ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me të njëjtën procedurë ligjore të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Nënshkruar në Tiranë, më 5.7.2023, në 2 (dy) kopje origjinale, në shqip.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ministër

Frida Krifca

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ministër

Faton Peci

Prishtinë, më 6.7.2023